



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 3/145

Datë: 31/10/2017

Senati i UP-së, me kërkesë të Parlamentit të studentëve në mbledhjen e mbajtur me datë 31.10.2017 mori


V E N D I M

Për lejimin e afateve plotësuese të provimeve

1. Përveç tri afateve të rregullta: janar-shkurtit, qershorit dhe shtatorit të parapara me nenin 111 të statutit të UP, Senati i Universitetit lejon edhe dy afate të tjera: *afatin e nëntorit* dhe *afatin e prillit*.
2. Afati i nëntorit është afat plotësues. Në këtë afat studentët mund të paraqesin vetëm një provim. Provimet në afatin e nëntorit mbahen nën organizimin e njësive akademike të UP-së, gjatë dy fundjavëve të fundit të nëntorit. Provimi i dhënë në këtë afat nuk mund të llogaritet për kusht.
3. Afati i prillit është afat plotësues. Në këtë afat studentët mund të paraqesin vetëm një provim. Provimi në afatin e prillit mbahen nën organizimin e njësive akademike të UP-së, gjatë dy fundjavëve të fundit të prillit.
4. Hapja e afatit për paraqitjen e provimeve bëhet 20 ditë pune para fillimit të afatit të provimeve kurse mbyllja 5 ditë pune para fillimit të afatit të provimeve.
5. Ky vendim vlen nga viti akademik 2017/18 e në vijim deri në marrjen e një vendimi ndryshe.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. Menaxhmentit të UP-së;
2. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
3. Dekanëve të njësive akademike të UP-së;
4. Sekretarëve të njësive akademike;
5. Zyrtarit Ligjor të UP-së;
6. Arkivit të UP-së.



Prof. dr. Marjan Dema

Rektor i UP-së